

**RELACION**  
**PËR**  
**PROJEKTVEKDIMIN**  
**“PËR MIRATIMIN TË STRATEGJISË KOMBËTARE PËR**  
**MIGRACIONIN 2024-2030 DHE PLANIT TË SAJ TË VEPRIMIT, 2024-**  
**2026”**

**I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË**  
**ARRIHEN**

Projektakti i propozuar ka për qëllim miratimin e dokumentit të Strategjisë Kombëtare për Migracionin 2024-2030 dhe Planit të saj të Veprimit 2024-2026, i cili është përgatitur në vijim të strategjisë kombëtare për migracionin 2019-2022, që përfundoi afatin e zbatimit në dhjetor 2022.

Vizioni për migracionin është që “Deri në vitin 2030, në frymën e proceseve globale të migracionit dhe integritit të Shqipërisë në BE, të jepet një përgjigje gjithëpërfshirëse ndaj sfidave dhe mundësive të migracionit, në kuadrin e Shqipërisë”.

Në linjë me këtë vision, objektivi kryesor strategjik është “Qeverisja efektive e migracionit në Shqipëri, nëpërmjet adresimit dhe menaxhimit të problemeve dhe sfidave që dalin nga lëvizjet e migrantëve, me synim rritjen e ndikimit të migracionit në zhvillimin e vendit, në dobi të emigrantëve dhe shoqërisë shqiptare”.

Qeveria shqiptare synon të realizojë objektivin kryesor strategjik duke u fokusuar në tre qëllime kryesore politike: Garantimin e qeverisjes strategjike të migracionit, zhvillimin e politikave efektive për migracionin për arsye punësimi, duke rritur ndikimin pozitiv të migracionit në zhvillimin socio-ekonomik kombëtar/lokal, si dhe promovimin e migracionit të rregullt, mbrojtjen e të drejtave të migrantëve dhe integritimin e tyre në shoqërinë shqiptare.

## **II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Projektakti për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Migracionin dhe Planit të saj të Veprimit është në përputhje me programin politik dhe analitik të Këshillit të Ministrave.

Për sa i përket harmonizimit me politikat kombëtare, objektivat dhe masat e parashikuara në strategjinë e re janë të ndërlidhura me Programin e Qeverisë 2021-2025, ku një ndër prioritetet kryesore është vëmendja e shtuar ndaj promovimit të politikave për të rritur në maksimum përfitimet e migracionit për migrantët dhe shoqërinë shqiptare.

Strategjia Kombëtare për Migracionin 2024-2030 dhe Plani i saj i Veprimit 2024-2026, bazohet gjithashtu në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrimin Evropian (SKZHIE), e cila është një ndër dokumentet ombrellë të politikave dhe që siguron zhvillimin e vendit në të gjitha fushat, në përputhje me drejtimet strategjike dhe në kuadër të integritit të tij në BE. SKZHIE e konsideron migracionin si një aspekt të rëndësishëm në zhvillimin social dhe ekonomik të Shqipërisë.

Projektakti është parashikuar në Programin analitik të akteve për vitin 2023 si edhe në PKIE 2022-2024, kapitulli 24 "Liria, Drejtësia dhe Siguria", fusha e migracionit.

Qeverisja e mirë e migracionit mbetet një nga prioritetet globale të konfirmuara edhe në Axhendën 2030 për Zhvillimin e Qëndrueshëm, të cilën Shqipëria e ka miratuar dhe përcaktuar si pjesë të prioriteteve të veta. Në këtë linjë, ky dokument strategjik është hartuar në harmoni me në përputhje të plotë me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG) dhe më konkretisht objektivin 10.7 për zhvillimin e “Politikave të mirëmenaxhuara të migracionit”.

Dokumenti është në përputhje edhe me objektivat e Paktit Global për Migracionin (GCM) miratuar nga Shqipëria në vitin 2018.

## **III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Projektakti vjen si nevojë e vazhdimësisë së proceseve të nisura me strategjinë e mëparshme kombëtare për migracionin dhe përmirësimin të mëtejshëm të politikave të migracionit nëpërmjet plotësimit të mangësive të hasura në adresimin e suksesshëm të sfidave të migracionit gjatë këtyre viteve.

Miratimi i kësaj Strategjie vjen edhe si pjesë e detyrimeve kombëtare dhe e procesit të integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, për të përfunduar me sukses negociatat për Kapitullin 24 (Drejtësia,) të Acquis të BE-së, e cila përcakton qeverisjen e migracionit si një çështje thelbësore.

Një faktor kyç në qeverisjen e migracionit është përmirësimi i koordinimit ndërinstitucional dhe përcaktimi i qartë i roleve dhe i përgjegjësive të institucioneve përgjegjëse për migracionin. Ndonëse tashmë janë krijuar mekanizma për koordinimin ndërinstitucional për qeverisjen e migracionit, përmirësimi i mëtejshëm i tyre, si dhe i produktit që ato do të nxjerrin mbetet një nga sfidat kryesore të zbatimit të këtij dokumenti, ku roli kryesor drejtues do të bjerë mbi Ministrinë e Brendshme, si institucioni lider për migracionin në vend.

Ky koordinim do të arrihet përmes funksionimit të mekanizmit të dyfishtë të monitorimit, të përbërë nga Komiteti Teknik për Migracionin dhe Grupi Drejtues për Migracionin. Forcimi i koordinimit dhe bashkëpunimit ndërinstitucional me të gjithë aktorët e institucionet bashkëzbatuese të strategjisë, do të realizohet përmes nënshkrimit të disa marrëveshjeve partneriteti me aktorë joqeveritarë në fushën e migracionit për të përmirësuar zbatimin e politikave të migracionit. Projektakti parashikon edhe hartimin e një udhërrëfyesi për koordinimin dhe raportimin e masave sipas Planit të Veprimit.

Njëkohësisht, ndjekja e proceseve rajonale dhe ndërkombëtare, si dhe krijimi i partneriteteve të reja për migracionin e punës reflektojnë përpjekjet për një partneritet horizontal mes gjitha institucioneve në kuadër të mirëmenaxhimit të migracionit.

Zbatimi i strategjisë së mëparshme nxorri në pah rëndësinë e përcaktimit të qartë të përgjegjësive të institucioneve, si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal, që nevojitet për shpërndarjen e duhur të burimeve, koordinimin efektiv të aktiviteteve të përbashkëta dhe monitorimin dhe raportimin e duhur të progresit të të gjitha objektivave të caktuara për organet e ndryshme.

Konsultimet institucionale evidentuan si një nevojë prioritare forcimin e rolit të strukturave bashkiake për migracionin dhe diasporën. Plani i Veprimit parashikon

shprehimisht që procesi i krijimit dhe personelit të këtyre organeve të përfundojë deri në vitin 2026. Bashkëpunimi me qeverisjen lokale duhet të forcohet, për këtë qëllim dokumenti parashikon që zyrat lokale të migracionit dhe diasporës do të përfshihen më tej përmes shkëmbimit periodik të informacionit me Sekretariatit Teknik të Migracionit në Ministrinë e Brendshme.

Projektakti do të synojë që hartimi dhe rishikimi i politikave të migracionit të jetë i bazuar në të dhëna të sakta dhe të koordinuara. Në këtë drejtim do të krijohet një metodologji për të koordinuar mbledhjen e të dhënave në përputhje me Programin Zyrtar të Statistikave.

Strategjia ka fokus të veçantë në forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe partneriteteve globale për migrim të sigurt dhe të rregullt. Ky objektiv është në thelb të Paktit Global për Migracionin, si dhe mbështet detyrimet e vendit në kuadër të proceseve rajonale dhe ndërkombëtare, interesin për zbatimin e mëtejshëm dhe përfundimin e aranzhimeve të punës për kthimin dhe ripranimin (siç përcaktohet në Strategjinë e BE-së për Kthimin Vullnetar dhe Riintegrimin).

Parandalimi i migrimit të parregullt drejt dhe nga Shqipëria do të vijojë të trajtohet me prioritet, si një objektivi i ndërlidhur me Strategjinë Ndërsektoriale të Menaxhimit të Integruar të Kufirit dhe Planin e Veprimit 2021-2027, si dhe me angazhimet e Shqipërisë sipas Kapitullit 24 të acquis të BE-së.

Duhet theksuar se gjatë këtyre viteve flukset e azilkërkuesve dhe emigrantëve në situatë të parregullt nga Shqipëria në vendet e BE-së dhe zonën Schengen kanë pësuar ulje, por vijojnë të ekzistojnë si fenomene. Projektakti parashikon ndërhyrje konkrete lidhur me përgatitjen e materialeve informuese dhe zhvillimin e fushatave informuese për publikun për emigrantët shqiptarë potencialë, mbi mundësitë e tregut të punës në Shqipëri, si dhe publikimin e adresave të sporteleve të migracionit në zyrat e punës dhe në bashki, ku ata mund të drejtohen për të marrë këto shërbime.

Strategjia synon të kapitalizojë suksesin e aktiviteteve të tilla parandaluese afatgjata, duke adresuar te qytetarët shqiptarë informacion të plotë dhe të saktë mbi pasojat e shkeljes së kushteve të hyrjes dhe qëndrimit, si në kufi (që synojnë udhëtarët) ashtu edhe brenda vendit (informimi migrantët e mundshëm). Rëndësia e shpërndarjes së informacionit dhe ndërgjegjësimit për rreziqet e migrimit të parregullt dhe përfitimet nga pajtueshmëria me kushtet ligjore të migracionit theksohet në një masë prioritare të dedikuar.

Projektakti promovon faktin se zhvillimi i politikave efektive për migracionin për arsye punësimi, do të rrisë ndikimin pozitiv të migracionit në zhvillimin socio-ekonomik kombëtar/lokal. Nëpërmjet ndërhyrjeve konkrete do të synohet që deri në vitin 2026 të përmirësohen mekanizmat institucionalë, financiarë, bankarë dhe fiskalë, për të nxitur kanalet formale të dërgesave dhe përdorimin e tyre si burim investimi e zhvillimi. Gjithashtu do të shtohet lufta kundër informalitetit, sidomos në tregun e punës, duke ndikuar edhe në shkurajimin e fluksit emigrator.

Nëpërmjet këtij dokumenti do të synohet të merren masa për forcimin e mekanizmit të riintegrit, duke siguruar mbështetjen dhe riintegrimin e qëndrueshëm të të kthyerve, nëpërmjet vlerësimit të nevojave dhe vështirësive që ata hasin me qëllim adresimin e tyre në mënyrë efektive.

Projektakti parashikon nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit ndërmjet strukturave që zbatojnë marrëveshjet e ripranimit dhe strukturave që ofrojnë shërbime punësimi, formimi profesional, ndihmës ekonomik, sociale me qëllim orientimin e personave të ripranuar në shërbimet e kërkuara.

Strategjia është gjithashtu e ndërlidhur me përpjekjet e strukturave shqiptare për parandalimin e migracionit të parregullt, të fokusuar në kontrollin e statusit të qëndrimit të shtetasve të huaj në Shqipëri.

Rritja e numrit të të huajve që hyjnë dhe qëndrojnë në Shqipëri për motive të ndryshme ka sjellë nevojën që institucionet përgjegjëse të bashkëpunojnë më ngushtësisht me qëllim vlerësimin e politikave/programeve dhe të kuadrit institucional mbi aksesin në shërbimet për imigrantët. Gjithashtu nëpërmjet projektaktit do të hartohet një kuadër për vlerësimin e detajuar të statusit të zbatimit të konventave të ratifikuara dhe ndikimit të tyre në garantimin e të drejtave të imigrantëve.

Projektakti parashikon organizimin e fushatave të informimit për zbatimin e normave mosdiskriminuese dhe për procedurat e ankimimit, si dhe ofrimin e informacionit në të gjitha Pikat e Kalimit Kufitar, nëpërmjet fletëpalosjeve/broshurave informuese mbi mundësitë e integrit në territorin e RSH-së, si dhe aksesin në shërbime bazë.

Projektakti garanton forcimin e bashkëpunimit me partnerët dhe grupet e interesit, si një dokument gjithëpërfshirës në drejtim të arritjes së objektivit të përbashkët që është qeverisja e migracionit në Shqipëri. Dokumenti parashikon përfshirjen e organizatave ndërkombëtare që punojnë në Shqipëri, delegacionit të Bashkimit

Evropian, shoqërisë civile, sektorit publik, akademisë etj, në zhvillimin e aktiviteve dhe në monitorimin e zbatimit të tyre.

#### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Projektakti është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe është hartuar duke marrë në konsideratë Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022-2030 (SKZHIE).

Ky projektvendim ndërthur parimet kombëtare për migracionin me politikat migratore të BE-së, në linjë me paktin për migracionin dhe azilin të Bashkimit Evropian.

Prioritetet, objektivat dhe ndërhyrjet e dokumentit përputhen plotësisht me Paktin Global për Migracionin (GCM) dhe Komunikatën e Komisionit për Parlamentin dhe Këshillin Evropian mbi Strategjinë e BE-së “Për kthimin dhe riintegrimin vullnetar”, datë 27.04.2021 - EUR-Lex - 52021DC0120.

#### **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS TË BASHKIMIT EVROPIAN (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)**

Projektakti ndërthur parimet e kombëtare për migracionin me politikat migratore të BE-së, në linjë me paktin e Bashkimit Evropian për migracionin dhe azilin, si dhe Komunikatën e Komisionit për Parlamentin dhe Këshillin Evropian mbi Strategjinë e BE-së “Për kthimin dhe riintegrimin vullnetar”.

#### **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT**

Në hyrje të projekt aktit gjejmë tabelën e përmbajtjes që pasqyron të pesta pjesët e dokumentit, si vijon:

**Pjesa i**, paraqet kontekstin strategjik. Në këtë pjesë paraqitet hyrja dhe qëllimi i dokumentit, kuadri ligjor dhe institucional, arritjet, mësimet, vizioni i strategjisë dhe treguesit e impaktit dhe rezultatit.

**Në pjesën ii** të dokumentit përcaktohet qëllimi i politikave dhe objektivat specifike të strategjisë. Kjo pjesë analizon tre qëllime të politikës si vijon:

1. Qëllimi i politikës i: garantimi i qeverisjes strategjike të migracionit në shqipëri
2. Qëllimi i politikës ii: zhvillimi i politikave efektive për migracionin për arsye punësimi, duke rritur ndikimin pozitiv të migracionit në zhvillimin socio-ekonomik kombëtar/lokal.
3. Qëllimi i politikës iii: promovimi i migracionit të rregullt, mbrojtja e të drejtave të migrantëve dhe integrimi i tyre në shoqërinë shqiptare

**Pjesa iii** paraqet projektet/programet kombëtare të zhvillimit për zbatimin e strategjisë, duke u fokusuar te projekti/programi zhvillimor.

**Pjesa iv** e dokumentit bën një pasqyrë të zbatimit, përgjegjësive të institucioneve, llogaridhënies, raportimit dhe monitorimit.

**Në pjesën e v**, është integruar plani i veprimit dhe burimet financiare për zbatimin e dokumentit, si dhe në fund katër anekse si më poshtë vijon:

Aneksi 1: formati i planit të veprimit të përmbledhur;

Aneksi 2: formati i planit të veprimit të kostuar dhe detajuar;

Aneksi 3: formatet e pasaportave të indikatorëve;

Aneksi 4: formatet e masave prioritare.

## **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT**

Institucionet/organet për zbatimin e këtij projektakti janë të gjitha ministrinë e linjës dhe institucionet qendrore, për të cilat në Strategji dhe në planin e veprimit janë përcaktuar detyra të veçanta, për zbatimin e këtij vendimi.

## **VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT**

Me Urdhërin e Kryeministrit nr. 9, datë 26.1.2023 u krijua Grupi Ndërinstitucional i Punës për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Migracionin dhe Planit të saj të

Veprimi, i kryesuar nga zëvendësministri i brendshëm dhe që në përbërje kishte anëtarë, përfaqësues të: Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

Gjithashtu është miratuar urdhri i Ministrit të Brendshëm nr.33 datë 13.3.2023 “Për ngritjen e grupit të punës në Ministrinë e Brendshme për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Migracionin dhe planit të saj të veprimit”.

Takimi i parë i Grupit Ndërinstitucional të Punës (GNP) u mbajt në datë 21 qershor 2023, në ambientet e Hotel Tirana Internacional. Në këtë takim morën pjesë edhe anëtarët e Grupit Drejtues për Migracionin (ngritur me urdhër të Kryeministrit nr. 35, datë 10.3.2021). Në takim u ftuan dhe morën pjesë edhe përfaqësues nga institucionet e tjera të përfshira dhe organizatat ndërkombëtare. Takimi pati në fokus të diskutimit problematikat e dala gjatë zbatimit të strategjisë dhe rekomandimet e Raportit përfundimtar të Progresit të zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Migracionin dhe Planit të Veprimit 2019-2022. Në takim u miratuan qëllimet politike dhe objektivat strategjike.

Me qëllim vijimin e punës në përputhje me prioritet e përcaktuara Ministria e Brendshme me mbështetjen e IOM kanë organizuar disa workshop-e kombëtare, në datat 9, 10 dhe 19 maj 2023. Workshop-et informuese të datave 9 dhe 10 maj kanë qenë të lidhura me zbatimin e Paktit Global për Migracionin (GCM) dhe identifikimin e objektivave prioritarë të tij që do të përfshihen në dokumentin strategjik.

Më 9 Maj 2023 u zhvillua një workshop-i me përfaqësuesit e institucioneve kryesore të Qeverisë së Shqipërisë dhe më 10 Maj 2023 një workshop me partnerët dhe grupet e interesit, ku morën pjesë përfaqësues nga organizatat ndërkombëtare që punojnë në Shqipëri, shoqëria civile, sektori publik, akademia etj.

Në datën 19 maj 2023, Ministria e Brendshme organizoi, me mbështetjen e IOM-it, një tjetër workshop “Për vlerësimin e situatës aktuale dhe prioritetëve kryesore në fushën e migracionit në Shqipëri, në funksion të hartimit të draftit të ri. Strategjia Kombëtare për Migracionin dhe Plani i Veprimit”. Në këtë takim punë morën pjesë përfaqësues të grupit ndërinstitucional për hartimin e Strategjisë, përfaqësues nga MB dhe institucionet kryesore përgjegjëse për migracionin, si dhe ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë nga IOM. Gjatë takimit u prezantua një kornizë/strukturë



fillestare e Strategjisë së ardhshme nga Sekretariati Teknik për Migrim në MB dhe ekspertë mbështetës të IOM-it.

Në datat 20-21 Shtator 2023, u zhvillua në Pogradec një workshop mbi hartimin e Strategjisë Kombëtare Për Migracionin dhe Planit të Veprimit 2024-2030, ku ishin të ftuar, anëtarët e GNP-së, si dhe përfaqësues të të gjithë institucioneve të parashikuara si zbatuese kryesore dhe bashkëzbatuese të ndërhyrjeve konkrete. Workshopi u moderua dhe monitorua nga Sekretariati Teknik për Migracionin në MB, dhe ekspertët e IOM. Pjesëmarrësit u ndanë në 3 grupe tematike pune, referuar qëllimeve politike të dokumentit strategjik dhe përfundimet e tyre u reflektuan në draft dokument.

Mbi bazën e kontributeve të marra nga institucionet, puna vijoi me hartimin e projekt-strategjisë dhe planit të veprimit.

#### **Procesi i konsultimit të draft Strategjisë me palët e interesuara:**

- Drafti është konsultuar rregullisht me Agjencinë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës.
- Më datë 8 shtator 2023 është thirrur takim konsultativ me të gjithë aktorët ndërkombëtarë, DBE, IOM, UNHCR, FRONTEX, EUAA etj, për të prezantuar objektivat e Strategjisë dhe konsultimin apo kërkesat eventuale për mbështetje nga ana e partnerëve.

### **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Në këtë kapitull të strategjisë paraqitet shpërndarja e kostove treguese dhe burimet financiare për financimin e aktiviteteve të Planit të Veprimit të dokumentit strategjik të Migracionit 2024 – 2030.

Kostimi i Strategjisë u realizua mbështetur në metodologjinë dhe praktikën e planifikimit buxhetor dhe është përfshirë vetëm periudha e parë e zbatimit të planit (2024-2026). Vlerësimi i kostove indikative është mbështetur gjithashtu në objektivat dhe treguesit e përcaktuar për arritjen e tyre, si dhe në masat, aktivitetet dhe produktet e identifikuara për secilin aktivitet. Përlllogaritjet buxhetore janë bërë duke përdorur instrumentin e rekomanduar nga IPSIS, të përshtatur sipas udhëzimeve përkatëse.

Procesi i kostimit u mbështet gjithashtu në konsultimin me Programin Buxhetor Afatmesëm 2024-2025 (faza e I), në konsultimet me të gjitha institucionet përgjegjëse për zbatimin e planit të veprimit, si dhe në kostot historike nga zbatimi i strategjisë së mëparëshme dhe strategjive të tjera ndërsektoriale. Në disa raste janë marrë në konsideratë dhe kostot e produkteve të PBA-së ose projekte të ngjashme.

Plani i veprimit për zbatimin e kësaj strategjie shoqërohet me një kostim analitik të secilës masë, i mbështetur në një detajim të hollësishëm të shpenzimeve për çdo aktivitet. Gjatë procesit të kostimit janë identifikuar shpenzimet për secilin aktivitet dhe ato janë klasifikuar në kategori shpenzuese të paracaktuara, sipas formatit IPSIS mbi metodologjinë e kostimit. Për kategori të caktuara shpenzimesh si pagat, shpenzimet e trajnimit, seminarët, shpenzimet e udhëtimeve, shpenzimet e ekspertëve dhe disa kategori pajisjesh janë përdorur kostot standarde të përcaktuara në metodologjinë e kostimit. Përlllogaritja e kostove është bërë sipas viteve financiare.

Kostoja e përgjithshme e përlllogaritur për zbatimin e planit të veprimit të dokumentit strategjik të Migracionit 2024 - 2030, për periudhën e parë trevjeçare është rreth 727.9 milionë Lekë, ose rreth 6.6 milionë Euro. Kursi mesatar për referencë është përlllogaritur me 110 lekë për 1 euro.

Tabela e mëposhtme, pasqyron kostot indikative, burimet e financimit dhe hendekun financiar përgjatë 3 viteve të zbatimit të Planit të veprimit 2024 - 2026.

Nevojat (në Lekë)					
Qëllimi i Politikës	Natyra/ Tipologjia e Kostove	Kosmet Totalë 2024-2026	Kosmete Planifikuara PBA 2024-2026 Buxheti & Donator	Kosmete Planifikuara në Buxhetin 2027-2030	Hendeku Financiar 2024-2026
Qëllimi Politikës 1: Garantimi qeverisjes strategjike të migracionit në Shqipëri	Kosmete	222,642,922	182,320,522	0	139,822,400
	Kapitale	161,000,000	11,500,000	0	
Qëllimi Politikës 2: Zhvillimi i politikave të efektshme për migracionin për motive punës midale uritur nd këimin pozitiv të migracionit tek zhvillimi socio-ekonomik kombëtar/bal.	Kosmete	211,248,744	198,037,995	0	16,082,749
	Kapitale	2,875,000	0	0	
Qëllimi Politikës 3: Pashmimi i migracionit të rregullt dhe mbrojtja e të drejtave të migrantëve dhe integrimi i tyre në shoqërinë shqiptare	Kosmete	118,635,806	0	0	130,135,806
	Kapitale	11,500,000	0	0	
<b>TOTALI [Lekë]</b>		<b>727,899,472</b>	<b>391,858,517</b>	<b>0</b>	<b>336,040,955</b>
<b>TOTALI [Euro]</b>		<b>6,617,268</b>	<b>3,562,350</b>	<b>0</b>	<b>3,054,918</b>
	<i>1 euro 110 Lekë</i>				

Tabela: Kostot indikative të dokumentit strategjik të Migracionit 2024 – 2030.

Për periudhën afatmesme 2024-2026, shpenzimet e planifikuara në buxhetet e institucioneve përgjegjëse janë rreth 391.8 milionë lekë, të cilat janë planifikuar në buxhetin vjetor dhe Programin Buxhetor Afatmesëm 2024-2026.

Për periudhën 2027-2030, kostoja indikative do të llogaritet pas raportit të monitorimit për periudhën 2024-2026 dhe rishikimit të planit të veprimit.

Hendeku financiar për të gjithë periudhën 2024-2026 është 336 milionë lekë ose 30.3% e kostove indikative. Për periudhën 2024-2026, buxheti i shtetit pritet të financojë 65.2% të kostove indikative totale të zbatimit të planit për periudhën 2024-2026, ndërsa financimi huaj i identifikuar është vetëm 4.6%.

**MINISTRI**

**TAULANT BALLA**